

KOMISIONERI

për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Revista nr. 6

Informim Dhe Privatësi



Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, fitues i "Çmimit Global për Privatësinë dhe Mbrojtjen e të Dhënave 2018" në kategorinë "Edukimi dhe Ndërgjegjësimi Publik", akorduar nga Konferenca 40-të Ndërkombëtare e Komisionerëve të Privatësisë dhe Mbrojtjes së të Dhënave 2018 dhe organizator i Konferencës së 41-të Ndërkombëtare të Komisionerëve të Privatësisë dhe Mbrojtjes së të Dhënave 2019.

Nr. 6
Dhjetor 2018

Përmbajtja

“Pulla postare shqiptare” fituese e “Çmimit Global për Privatësinë dhe Mbrojtjen e të Dhënave 2018”.....	faqja 3
“Debati etik: dinjiteti dhe respekti në epokën e të jetuarit bazuar tek të dhënat”.....	faqja 4
Institucionet kombëtare për të drejtat e njeriut nënshkruajnë marrëveshje bashkëpunimi.....	faqja 6
Dita Ndërkombëtare për të Drejtën e Informimit, takim i hapur me nxënësit e shkollave të mesme.....	faqja 7
“E drejta për informim” - Forumi i 3-të Konsultativ Antikorrupsion.....	faqja 8
Takim informues dhe monitorues me deputetë të Kuvendit të Shqipërisë.....	faqja 9
Marrëveshje bashkëpunimi me Autoritetin e Landit gjerman Baden-Württemberg.....	faqja 10
“Projekti i Binjakëzimit Antikorrupsion”, rritje e transparencës së Autoriteteve Publike.....	faqja 11
“Instrumenti i Vetëvlerësimit të Autoritetit Publik”, trajnim me koordinatorët e institucioneve qendrore.....	faqja 11
Modeli i ri i Programit të Transparencës për organet e vetëqeverisjes vendore.....	faqja 12
Zbatimi i ligjit “Për të drejtën e informimit” nga organet e vetëqeverisjes vendore.....	faqja 12
Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, Konferenca vjetore e Avokatit të Popullit.....	faqja 13
Forum “Konkurrenca dhe biznesi”.....	faqja 13
Mbrojtja e të dhënave personale në sistemin e kujdesit shëndetësor.....	faqja 14
Transparenca në GDPR, trajnim i stafit të Zyrës së Komisionerit.....	faqja 14
Veprimtaria e sistemit bankar e financiar në kuadër të mbrojtjes së të dhënave personale.....	faqja 15
“Testi i interesit publik”, transparencë dhe llogaridhënie nga Autoritetet Publike.....	faqja 15
Bashkëpunim dhe shkëmbim eksperience me institucione të Republikës së Maltës.....	faqja 16
“Në lëvizje”, Festivali shqiptar antikorrupsion.....	faqja 16
Veprimtaria e pushtetit vendor në raport me balancën mes të drejtës për informim dhe mbrojtjes së të dhënave personale.....	faqja 17
Mbrojtja e të dhënave personale në sistemin arsimor jopublik.....	faqja 17
Mbyllet fushata “Privatësi dhe Siguri”.....	faqja 18
Konferenca “Të drejtat e njeriut dhe drejtësia gjinore”.....	faqja 18

Print:

Revista “Informim Dhe Privatësi”

Apa Albpartners sh.a.

Përgatitet dhe botohet nga Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Dhjetor 2018

Adresa: Rr. “Abdi Toptani”, Nd. 5, Kodi postar 1001, Tiranë

Redaksia: Irma Arapi, Alketa Koja, Redi Skënderaj, Erald Mullaraj



“Pulla postare shqiptare” fituese e “Çmimit Global për Privatësinë dhe Mbrojtjen e të Dhënave 2018”

“Pulla postare shqiptare” fiton “Çmimin Global për Privatësinë dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale 2018” në kategorinë “Edukimi dhe ndërgjegjësimi publik”. Ky projekt i Zyrës së Komisionerit konkurroi përkrah 43 aplikimesh të tjera nga Autoritete homologe nga e gjithë bota. Ceremonia e ndarjes së “Çmimit Global” ishte një nga aktivitetet kryesore në kuadër të Konferencës së 40-të Ndërkombëtare të Komisionerëve të Mbrojtjes së të Dhënave dhe Privatësisë (ICDPPC) “Debati etik: dinjiteti dhe respekti në epokën e të jetuarit bazuar tek të dhënat – Debating Ethics: Dignity and respect in data driven life”, që i

zhvilloi punimet në Bruksel. “Pulla postare shqiptare” u prezantua më 28 Janar 2018, si aktiviteti qendror në kuadër të Ditës Evropiane të Mbrojtjes së të Dhënave Personale. Ky projekt, ambicioz dhe i veçantë në llojin e tij, u iniciua që në vitin 2016. Pasi mori vlerësimin e Komisionit Shtetëror, pulla u përfshi në tematikat për t’u emetuar gjatë vitit pasardhës dhe doli në qarkullim për herë të parë në 28 dhjetor 2017. Dizajni fitues, i përzgjedhur në konkursin e realizuar nga Posta Shqiptare, i përket piktorit Artion Baboçi.



Pulla përfaqëson në tërësi konceptin e mbrojtjes së privatësisë dhe të dhënave personale, duke përdorur shumë elementë të raportit që ka sot individi me teknologjinë.

“Çmimi Global” u akordohet fituesve nga 4 kategori specifike dhe një i pestë, si zgjedhje e përgjithshme e anëtarësisë së Konferencës. Këtë vit u ndërruan me çmime Autoriteti Britanik (ICO), Autoriteti Francez (CNIL) në 2 kategori dhe Autoriteti Belg (APD-GBA) me “Çmimin e anëtarësisë”.

“Debati etik: dinjiteti dhe respekti në epokën e të jetuarit bazuar tek të dhënat”

Me temë “Debati etik: dinjiteti dhe respekti në epokën e të jetuarit bazuar tek të dhënat – Debating Ethics: Dignity and respect in data driven life”, në datat 22-26 tetor 2018, zhvilloi në Bruksel punimet Konferenca e 40-të Ndërkombëtare e Komisionerëve të Mbrojtjes së të Dhënave dhe Privatësisë (ICDPPC). Aktiviteti u bashkëorganizua nga Mbikëqyrësi Evropian i Mbrojtjes së të Dhënave (EDPS) dhe Komisioneri i Mbrojtjes së të Dhënave të Bullgarisë (CPDP). Titullarë dhe përfaqësues të 119 Autoriteteve kombëtare dhe rajonale anëtare të Konferencës nga të gjitha kontinentet, si dhe nga 20 institucione e organizata të ndryshme ndërkombëtare në cilësinë e vëzhguesit, shqyrtuan zhvillimet kryesore në këtë fushë dhe ku duhet përqendruar fokusi për të ardhmen.



Konferenca Ndërkombëtare në sesion e mbyllur të saj miratoi këto dokumente: “Rezoluta për përmirësimin e rregullave dhe procedurave të Konferencës Ndërkombëtare”; “Rezoluta për të ardhmen e Konferencës Ndërkombëtare” – ku Zyra e Komisionerit ka dhënë kontributin e saj;



“Rezoluta për bashkëpunimin mes Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit”; “Rezoluta për platformat e edukimit online”; “Rezoluta për Censurin e Konferencës Ndërkombëtare” dhe “Deklarata për etikën dhe mbrojtjen e të dhënave në përdorimin e inteligjencës artificiale”.

Në ditën e dytë të punimeve të Konferencës e mori fjalën edhe z. Besnik Dervishi, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Tema të tjera që u diskutuan ishin ato për “Etikën dhe mbrojtjen e të dhënave në përdorimin e inteligjencës artificiale” dhe “Ecurinë e zbatimit të Rregullores së Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave në BE (GDPR)”. Çdo Grup Pune raportoi për veprimtarinë e tij vjetore dhe prezantoi aktivitetet për të ardhmen, ndërsa u zhvilluan takime mes Autoriteteve anëtare të Rrjeteve të ndryshme të fushës.

Komisioneri Dervishi, prej 23 tetorit 2018, është anëtar me të drejta të plota i Komitetit Ekzekutiv, në cilësinë e kreu të Autoritetit organizator të Konferencës Ndërkombëtare (ICDPPC) pasardhëse. Presidenti i ri i këtij organizmi u zgjodh znj. Elizabeth Denham, Komisioneri i Informimit të Mbretërisë së Bashkuar,



e cila pason në këtë detyrë znj. Isabelle Falque-Pierrotin, President i Autoritetit të Francës. Komiteti Ekzekutiv përbëhet nga z. Giovanni Buttarelli, Mbikëqyrësi Evropian i Mbrojtjes së të Dhënave; z. Ventislav Karadjov, Komisioneri i Bullgarisë; znj. Marguerite Ouedraogo Bonane, kreu i Autoritetit të Burkina Fasos; znj. Angelene Falk, Komisioner i Australisë dhe z. Raymond Enriquez Liboro, kreu i Autoritetit të Filipineve. Komisioneri i Meksikës, z. Francisco Javier Acuña Llamas, u zgjodh anëtar-vëzhgues, duke qenë se edicioni i 42-të i Konferencës Ndërkombëtare, në vitin 2020, është miratuar të zhvillohet në këtë vend. Komiteti Ekzekutiv ushtron funksione koordinuese në procesin e hartimit të dokumenteve, politikave dhe standardeve, të cilat aprovohen më pas nga anëtarësia e Konferencës Ndërkombëtare.



Në dy ditët e sesionit të hapur u diskutua më gjerësisht edhe me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga organizatat e shoqërisë civile, botës akademike dhe kompanive të sektorit privat, për etikën në procesin e përdorimit të të dhënave personale në ambientin digjital. Nëpërmjet eksperiencave konkrete u pasqyruan risitë në këtë proces, i cili duhet të udhëhiqet nga transparenca dhe integriteti, si në aspektin rregullator ashtu edhe në atë teknik.

Një pjesë e konsiderueshme e diskutimeve në Konferencën Ndërkombëtare iu kushtua bashkëpunimit mes agjencive ligjzbatuese, për adresimin e problematikave të mprehta të konstatuara nga keqpërdorimi/përdorimi i të dhënave personale në rrjetet sociale.



Institucionet kombëtare për të drejtat e njeriut nënshkruajnë marrëveshje bashkëpunimi



Institucionet e Avokatit të Popullit, Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi nënshkruan një marrëveshje bashkëpunimi. Dokumenti u hartua me koordinimin dhe mbështetjen e Prezencës së OSBE në Shqipëri.

Kreu i Prezencës së OSBE, z. Bernd Borchart tha se “shoqëria shqiptare ka nevojë për zgjidhje konkrete në fushën e respektimit të të drejtave të njeriut”.

Avokati i Popullit, znj. Erinda Ballanca theksoi se “për pikëpamjen tonë, mbrojtja e të drejtave të njeriut është një fushë, ku jo vetëm ka nevojë për të gjithë, por ku është e domosdoshme që lojtarët e skuadrës sonë të jenë sa më të shumtë”.



Z. Besnik Dervishi theksoi se “tashmë kemi mbi 200 vendime, disa prej të cilave kanë shtruar një rrugë të pa guxuar më parë. Dhe këtu e kam fjalën për vendime që kanë urdhëruar transparencën për Autoritete Publike të niveleve më të larta, në fusha tabu, si koncesionet, prokurimet publike, dosjet gjyqësore e ato të organit të prokurorisë, arbitrazhin, sekretin shtetëror apo keqpërdorimin e termi konfidencialitet, si dhe në transparencën e punës së organeve të veçantë”.



Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, z. Robert Gajda, nxiti “krijimin e një aleance të madhe dhe të qëndrueshme midis institucioneve të të drejtave të njeriut, organeve të tjera publike, atyre të pavarura dhe organizatave të shoqërisë civile, në luftë kundër diskriminimit, pabarazive dhe të gjitha padrejtësive”.

Marrëveshja synon të rrisë dhe forcojë efektivitetin institucional në respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut nga organet e administratës publike dhe më gjerë. Gjithashtu, dokumenti i angazhon palët të ndërthurin përvojën dhe kapacitetet e tyre për rritjen e performancës dhe të rezultateve të punës së institucioneve respektive.

28 Shtator - Dita Ndërkombëtare e të Drejtës për Informim, takim i hapur me nxënësit e shkollave të mesme të Tiranës



Në “Ditën Ndërkombëtare të të Drejtës për Informim” u zhvillua në mjediset e Kryesisë së Kuvendit aktiviteti ndërgjegjësues me pjesëmarrjen e nxënësve dhe mësuesve të shkollave të mesme të kryeqytetit. I bashkëorganizuar nga Kuvendi, Zyra e Komisionerit, Prezenca e OSBE dhe Drejtoria Arsimore Rajonale e Tiranës, takimi u mbajt në formatin e diskutimit të hapur për njohjen e të rinjve me një nga të drejtat dhe

liritë themelore të njeriut, të drejtën e informimit, e sanksionuar në nenin 23 të Kushtetutës. Për znj. Vasilika Hysi, Nënkryetare e Kuvendit, ka rëndësi pjesëmarrja e të rinjve në procesin ligjvënës. “Ju keni të drejtën të informoheni për të gjitha ligjet që miratohen. Ju keni të drejtë të dëgjoheni dhe të jepni mendimin për projektligjet. Për të gjitha projektligjet, që ndikojnë në jetën tuaj, si të rinj, por edhe të familjarëve tuaj”.

Z. Besnik Dervishi, duke theksuar simbolikën e kësaj date, vlerësoi se “ligji garanton njohjen e publikut me informacionin zyrtar, duke rritur transparencën dhe përgjegjshmërinë e Autoriteteve Publike. Ligji ndërgjegjëson dhe nxit qytetarët për ushtrimin në praktikë të kësaj të drejte, si një nga instrumentet për llogaridhënien e institucioneve shtetërore”. Përfaqësuesi i Prezencës së OSBE, z. Claudio Pala, tha se “kjo e drejtë është e rëndësishme për demokracinë, duke rritur kontrollin e qytetarëve apo shoqërisë civile në vendimmarrjen e organeve shtetërore.”



Komisioneri Dervishi i ftoi gjimnazistët të jenë sa më aktiv dhe pjesëmarrës nëpërmjet nismave të ndryshme, pjesë e aktiviteteve shkollore, në promovimin e të drejtës për informim. 28 Shtatori është vendosur si “Dita Ndërkombëtare e të Drejtës për Informim” që prej vitit 2002. Autoritete homologe apo organizata të shoqërisë civile organizojnë aktivitete për promovimin e kësaj të drejte në praktikë.

“E drejta për informim”, Forumi i 3-të Konsultativ Antikorrupsion



Zyra e Komisionerit dhe Ministria e Drejtësisë organizuan Forumin e 3-të Konsultativ Antikorrupsion me temë “E drejta për informim”. Të pranishëm në këtë takim ishin përfaqësues të Autoriteteve Publike, të botës akademike, nga organizata të shoqërisë civile dhe media. Forumi është pjesë e agjendës së “Projektit të Binjakëzimit Antikorrupsion Shqipëri-BE”.

Z. Besnik Dervishi prezantoi legjislacionin për të drejtën e informimit, risitë dhe sfidat e tij dhe rolin

mbikëqyrës të Zyrës së Komisionerit. “Në këta 4 vjet, vlerësojmë se institucionet shtetërore kanë bërë përpjekje të dukshme për përmbushjen e detyrimeve të ligjit “Për të drejtën e informimit”. Reforma për ndryshimin e mentalitetit të administratës publike është po aq me rëndësi sa edhe reforma në sistemin e drejtësisë. Përmirësimi i ligjit është rruga drejt standardeve më të larta për garantimin e transparencës dhe llogaridhënies së Autoriteteve Publike” – tha Komisioneri.

Znj. Teuta Vodo, zëvendësministër i Drejtësisë, nënvizoi rëndësinë e zhvillimit të takimit. Ajo tha se Qeveria është e angazhuar maksimalisht në përmbushjen e detyrimeve në kuadër të procesit të integritimit evropian, duke përfshirë edhe zbatimin e masave antikorrupsion.



Në Forum, znj. Ersida Sefa, përfaqësuese e Fondacionit “Shoqëria e Hapur për Shqipërinë”, diskutoi për temën “E ardhmja digjitale e të drejtës për informim”. Znj. Eralda Met’hasani Çani, përfaqësuese e botës akademike, prezantoi risitë e “Kodit të Procedurave Administrative në raport me të drejtën e informimit”. Ndërsa, z. Njazi Jaho, këshilltar ligjor pranë Komitetit Shqiptar të Helsinkit foli për marrëdhënien e qytetarit me këtë të drejtë dhe liri themelore. Në takim,

diskutuan edhe znj. Rovena Sulstarova, përfaqësuese e Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim, për transparencën e organeve të vetëqeverisjes vendore; si dhe znj. Kristina Voko, nga BIRN Albania, për raportin e medias me të drejtën e informimit.



Takim informues e monitorues me deputetë të Kuvendit të Shqipërisë



Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut të Kuvendit të Shqipërisë zhvilloi në mjediset e Zyrës së Komisionerit një takim informues dhe monitorues për veprimtarinë e institucionit për vitin 2018. Në këtë takim ishin të pranishëm, Kryetari i këtij Komisioni, z. Ulsi Manja dhe anëtarët znj. Vasilika Hysi, znj. Klotilda Bushka, z. Bashkim Fino, z. Bledi Çuçi, z. Alket Hyseni, z. Edmond Leka dhe z. Jurgis Çyrbja.

Komisioneri, z. Besnik Dervishi, i njohu deputetët me rolin e Autoritetit si institucion i pavarur dhe përgjegjës për mbikëqyrjen dhe monitorimin e akteve rregullatore, ligjit “Për të drejtën e informimit” dhe atë “Për mbrojtjen e të dhënave personale”. Të pranishmit u informuan mbi veprimtarinë e kontrollit dhe hetimeve administrative lidhur me respektimin e këtyre dy të drejtave; hetimeve proaktive me iniciativë të Zyrës së Komisionerit në lidhje me procesin e mbledhjes/përpunimit të të dhënave personale nga kompani të mëdha publike apo private dhe mbi ecurinë e transparencës së Autoriteteve Publike, me fokus të veçantë ministritë dhe organet e pushtetit qendror. Komisioneri dhe stafi iu përgjigjën pyetjeve dhe interesimit të deputetëve për një sërë çështjesh në të dy fushat e kompetencave të institucionit, si dhe për sfidat kryesore në të ardhmen për përmirësimin e standardeve ligjore në garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të qytetarëve.

Në përfundim të takimit, Kryetari i Komisionit, z. Manja vlerësoi punën e deritanishme të Zyrës së Komisionerit, duke konfirmuar dhe përkrahjen e plotë të Kuvendit të Shqipërisë në të ardhmen. Njëkohësisht, ai garantoj mbështetjen e këtij institucioni për zhvillimin me sukses të Konferencës së 41-të Ndërkombëtare të Komisionerëve të Privatësisë dhe Mbrojtjes të Dhënave në Tiranë, në 21-24 tetor 2019.



Marrëveshje bashkëpunimi me Autoritetin e Landit Baden-Württemberg

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, z. Besnik Dervishi dhe Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave dhe Lirinë e Informimit të Landit Baden-Württemberg në Gjermani, z. Stefan Brink, nënshkruan marrëveshjen e bashkëpunimit mes dy institucioneve.

Z. Dervishi vlerësoi si mjaft të rëndësishëm bashkëpunimin ndërinstitucional, duke theksuar se “Zyra e Komisionerit ka disa marrëveshje me



Autoritete të ndryshme homologe për mbrojtjen e të dhënave personale. Por kjo është e veçantë, sepse është e para që përfshin edhe veprimtarinë e të drejtës për informim. Ne jemi të angazhuar maksimalisht për të qenë sa më aktiv në projekte dhe në bashkëpunimin ndërkombëtar”.

Ndërsa, z. Brink nënvizoi se “secili do të kontribuojë në këtë marrëveshje me traditën dhe asetet e tij institucionale. Njëkohësisht, Autoriteti që përfaqësoj është i gatshëm t’ju mbështesë maksimalisht në procesin e integritimit në Bashkimin Evropian”.

Marrëveshja synon, që shkëmbimi i eksperiencës dhe praktikave më të mira në zbatimin e legjislacionit respektiv kombëtar në të dy këto fusha, të garantojë standarde bashkëkohore për liritë dhe të drejtat themelore të qytetarëve. Ajo është, njëkohësisht, pjesë e aktiviteteve të parashikuara nga “Projekti i Binjakëzimit Antikorrupsion”, pjesë e të cilit është edhe Zyra e Komisionerit dhe që zbatohet në vendin tonë nga një konsorcium gjermano-austriak. Dokumenti mban në konsideratë përmirësimet e rëndësishme ligjore në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale (GDPR dhe modernizimin e Konventës 108 të Këshillit të Evropës), si dhe kuadrin ligjor evropian përsa i përket të drejtës për informim. Palët angazhohen, gjithashtu, të organizojnë dhe zhvillojnë aktivitete



të përbashkëta, si dhe të shkëmbejnë informacion për ndryshimet e kuadrit ligjor/rregullator në të dy fushat, me synim përmirësimin e vazhdueshëm të tij.

Një ditë përpara ceremonisë së nënshkrimit të marrëveshjes, z. Brik zhvilloi një seancë trajnuese me stafin e Zyrës së Komisionerit, ku prezantoi veprimtarinë dhe drejtimit kryesore të punës së Autoritetit që ai drejton.



“Projekti i Binjakëzimit Antikorrupsion”, rritje e transparencës së Autoriteteve Publike



Rritja e aksesit dhe njohurive për veprimtarinë e Autoriteteve Publike është një prej elementeve të rëndësishëm të politikave antikorrupsion. Për tre ditë me rradhë, u zhvilluan trajnime në mjediset e Qendrës për Përhapje dhe Dialog në Kryeministri (COD), në kuadër të “Projektit të Binjakëzimit Antikorrupsion Shqipëri-BE”, me

koordinimin e Zyrës së Komisionerit .

Në këto trajnime pjesëmarrës ishin koordinatorët e të drejtës për informim të ministrive dhe përfaqësues të strukturave të auditimit të brendshëm dhe njësisë të prokurimit publik në këto institucione dhe ato të varësisë. Të ftuara për të mbajtur prezantime ishin znj. Anamarija Musa, Komisionere për të Drejtën e Informimit e Kroacisë dhe ekspertja e projektit znj. Lena Andersson, nga Suedia. Trajnimet u përqëndruan tek procesi i dhënies së informacionit publik në përputhje me veprimtarinë specifike institucionale dhe mekanizmat ligjore në fuqi. Ndërveprimi i Autoriteteve Publike me qytetarët, organizatat e shoqërisë civile apo median në drejtim të rritjes së transparencës dhe llogaridhënies është faktor për të minimizuar korrupsionin.



“Instrumenti i Vetëvlerësimit të Autoritetit Publik”



Zyra e Komisionerit në bashkëpunim me Fondacionin “Shoqëria e Hapur për Shqipërinë”, organizuan trajnimin në lidhje me “Instrumentin e Vetëvlerësimit të Autoritetit Publik”. Në këtë aktivitet morën pjesë koordinatorët e të drejtës për informim të institucioneve të Presidencës, Kuvendit e Kryeministrisë dhe të të gjitha ministrive.

“Instrumenti i Vetëvlerësimit” është një dokument në formën e një pyetësori, i cili i shërben Autoritetit Publik për të vlerësuar në mënyrë objektive respektimin e dispozitave të ligjit “Për të drejtën e informimit”. Shqyrtimi i kujdesshëm i pyetjeve dhe përgjigjet identifikojnë nivelin e realizimit të këtyre detyrimeve rregullatore. Nga ana tjetër, Autoriteti Publik ka një pasqyrë të saktë të masave që duhet të marrë për përmirësimin e problematikave. Zyra e Komisionerit, në përfundim të këtij procesi, do të dalë me rekomandimet përkatëse për Autoritetet Publike, me qëllim përmbushjen e plotë të detyrimeve që burojnë nga ligji nr. 119/2014.

Modeli i ri i Programit të Transparencës për organet e vetëqeverisjes vendore



veprimtarinë e tyre. Njëkohësisht, ky dokument është

Komisioneri, z. Besnik Dervishi, me Urdhërin Nr. 211, datë 10.09.2018, miratoi Programin Model të Transparencës për organet e vetëqeverisjes vendore. Ai është i zbatueshëm për 61 bashkitë e vendit prej 1 janarit 2019. Hartimi i këtij dokumenti u realizua në kuadër të Projektit STAR 2, pjesë e të cilit është dhe Zyra e Komisionerit. Ky Program model Transparence reflekton më së miri specifikat e organeve të vetëqeverisjes vendore (bashkitë dhe këshillat bashkiakë), duke përmirësuar ndjeshëm informimin e qytetarëve për

përfshirë në planin e veprimit të “Strategjisë së Reformës në Administratën Publike”.

Zbatimi i ligjit “Për të drejtën e informimit” nga organet e vetëqeverisjes vendore



“Monitorimi Kombëtar 2018” për zbatimin e ligjit “Për të drejtën e informimit” nga 61 bashkitë e Shqipërisë, është raporti i hartuar nga Qendra për Çështjet e Informimit Publik (INFOCIP). Rezulton se përmbushja e detyrimeve ligjore është në nivelin 86.2%, çka përbën një tregues mjaft pozitiv për transparencën dhe llogaridhënien e organeve të vetëqeverisjes vendore. Në dy monitorimet e mëparshme treguesi i zbatueshmërisë ligjore ishte respektivisht, në nivelin 31% për vitin 2016 dhe 71% për 2017.

Zyra e Komisionerit i vlerëson maksimalisht gjetjet e “Monitorimit Kombëtar 2018” dhe do t’i mbajë në konsideratë në veprimtarinë e saj. Krahasimi i shifrave flet qartë për angazhimin e Autoriteteve Publike për përmbushjen e dispozitave të ligjit 119/2014, sidomos për mbikëqyrjen efektive të tij nga Zyra e Komisionerit dhe për rolin e organizatave të shoqërisë civile në këtë proces. Bashkitë e Korçës, Shkodrës, Tiranës, Durrësit e Lezhës, por edhe ato të Gramshit, Kamzës, Krujës, Roskovecit e Skraparit janë renditur në 10 pozicionet më të mira.

Në raport theksohet dhe fakti i “miratimit të Programit Model të Transparencës për organet e vetëqeverisjes vendore më 10 shtator 2018 nga Komisioneri”, si një instrument shumë i rëndësishëm dhe që i adreson të gjithë problematikat që edhe ky “Monitorim” ka konstatuar. Njëkohësisht, vlerësohet edhe “kontributi i institucionit për t’i dhënë zë shqetësimeve të ngritura nga aktorë/organizata të shoqërisë civile, duke aplikuar edhe sanksione ndaj bashkive”.

Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, Konferenca vjetore e Avokatit të Popullit

Me temë “70-vjetori i deklaratës së OKB për të drejtat e njeriut – 20-vjetori i Kushtetutës, Sa kanë përparuar të drejtat e njeriut në Shqipëri?” u zhvillua Konferenca vjetore e institucionit të Avokatit të Popullit, nën drejtimin e znj. Erinda Ballanca. Në këtë aktivitet ishte i ftuar dhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, z. Besnik Dervishi, i cili mbajti prezantimin “Sfida e transparencës për Autoritetet Publike dhe reforma në mbrojtjen e të dhënave personale”.



Punimet e kësaj Konference u përshëndetën nga znj. Vasilika Hysi, Nënkryetare e Kuvendit; znj. Senida Mesi, Zëvendëskryeministre; z. Bashkim Dedja, Kryetar i Gjykatës Kushtetuese; z. Brian Williams, Koordinator Rezident i Zyrës së OKB; z. Bernd Borchardt, Kreu i Prezencës së OSBE; znj. Monika Bylaite, përfaqësuese e Delegacionit të BE, z. Daniel Koski, Zv/ambasador në detyrë i SHBA dhe z. Olsi Dekovi, Zv/kreu i Zyrës së Këshillit të Evropës.

Në panelin e dytë të Konferencës u trajtuan tematika, çështje dhe zhvillime të kësaj fushe nëpërmjet prezantimeve nga z. Alket Jaupi, Ndhimëskomisioner – “Avokati i Popullit në Shqipëri, garanci kushtetuese për mbrojtjen e të drejtave të njeriut”; z. Ksenofon Krisafi, ish-Ambasador i Shqipërisë në OKB – “Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut dhe Shqipëria”; z. Robert Gajda, Komisioner për Mbrojtjen nga Diskriminimi – “Mbrojtja efektive e të drejtave të njeriut 20 vjet nga miratimi i Kushtetutës së Shqipërisë” dhe nga z. Altin Hazizaj, anëtar i Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile – “Ngushtimi i hapësirave për veprimet e Shoqërisë Civile për të drejtat e njeriut në Shqipëri”. Konkluzionet në përfundim të punimeve të Konferencës u mbajtën nga znj. Ballanca dhe z. Williams.



Forumi “Konkurrenca dhe biznesi”

“Konkurrenca dhe biznesi” ishte tema e Forumit të organizuar nga Autoriteti i Konkurrencës, nën drejtimin e kreut të këtij institucioni, znj. Juliana Latifi. Aktiviteti u mbajt edhe në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Konkurrencës.

Forumi u përshëndet nga i ftuari i nderit z. Gramoz Ruçi, Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë.

Aktiviteti ishte i ndarë në dy pjesë, me tematika: “Roli i Enteve Rregullatore për një konkurrencë të lirë dhe efektive në treg dhe bashkëpunimi me Autoritetin e Konkurrencës” dhe “Konkurrenca dhe biznesi – një dualitet i nevojshëm, dhe problematikat e tij në raport me konkurrencën”.

Në pjesën e parë, i ftuar për të mbajtur një prezantim ishte Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, z. Besnik Dervishi, i cili foli për raportin e privatësisë së individit me zhvillimin e teknologjisë dhe reformën rregullatore në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale në BE. Gjithashtu, në këtë panel mbajtën prezantime dhe z. Ilir Zela, Kryetar i Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare dhe z. Petrit Ahmeti, Kryetar i Bordit Drejtues të Entit Rregullator të Energjisë.

Mbrojtja e të dhënave personale në sistemin e kujdesit shëndetësor

Zyra e Komisionerit në bashkëpunim me Prezencën e OSBE në Shqipëri, organizuan aktivitetin me temë “Rregullat në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale në sistemin e kujdesit shëndetësor”. Pjesëmarrës në këtë takim ishin përfaqësues nga institucionet publike dhe subjektet private që ushtrojnë veprimtarinë në sektorin e shëndetësisë.

Z. Besnik Dervishi, theksoi rëndësinë që ka procesi i ndërgjegjësimit të qytetarëve, si dhe nënvizoi funksionimin e një mekanizmi të qëndrueshëm garancish nga operatorët e sistemit. Takimin e përshëndetën znj. Bardhylka Kospiri, zëvendësministër i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; z.



Emir Kamenica, përfaqësues i Prezencës së OSBE dhe z. Fatmir Brahimaj, President i Urdhrit të Mjekëve.

Znj. Pjerina Gaxha, Drejtori i Drejtorisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, mbajti një prezantim për të pranishmit, ku i njohu me ligjin “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, me aktet nënligjore të fushës, si dhe trajtimin e rasteve konkrete. Në këtë trajnim

i ftuar ishte eksperti i njohur ndërkombëtar i fushës, z. Angelo Trapana, President i Unionit Kombëtar të Organizmave të Akredituar në Romë. Nëpërmjet eksperiencës italiane dhe më gjerë, prezantimi i tij trajtoi procesin e certifikimit të institucioneve/kontrolluesve të sistemit shëndetësor.

Transparenca në Rregulloren e Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave Personale, trajnim i stafit të Zyrës së Komisionerit

“Transparenca në Rregulloren e Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave Personale të BE (GDPR)”, ishte tematika e trajnimit me stafin e Zyrës së Komisionerit. I ftuar si lektor ishte z. Stefan Niederer, përfaqësues i Autoritetit Federal të Gjermanisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Lirinë e Informimit. Ky trajnim është pjesë e aktiviteteve të “Projektit të Binjakëzimit Antikorrupsion Shqipëri-BE”.



Informimi i individit për mjetet dhe mënyrat e përpunimit të të dhënave të tij personale është një nga parimet dhe risitë kryesore të GDPR. Transparenca dhe përgjegjshmëria – si përsa i përket të drejtave të qytetarit, ashtu edhe për detyrimet që duhet të përmbushin “kontrolluesit”, në sektorin publik ose atë privat – është thelbësore për përpunimin e ligjshëm të të dhënave. Në trajnim u prekën edhe çështje që kanë të bëjnë me masat e sigurisë apo shkeljen e të dhënave personale (“data breach”) gjatë procesit të përpunimit të tyre, si dhe rolin e Autoritetit mbikëqyrës. Trajnimi është, gjithashtu, edhe kontribut në zgjerimin e njohurive në funksion të procesit të përafrimit të legjislacionit kombëtar me atë evropian në këtë fushë.

Veprimtaria e sistemit bankar e financiar në kuadër të mbrojtjes së të dhënave personale



Zyra e Komisionerit në bashkëpunim me Shoqatën Shqiptare të Bankave, organizuan aktivitetin me temë “Rregullat në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale në sistemin bankar”. Pjesëmarrës në këtë takim ishin përfaqësues nga Banka e Shqipërisë, nga të gjitha bankat e nivelit të dytë dhe nga shoqëritë financiare jobankare.

Aktivitetin e përshëndeti dhe z. Spiro Brumbulli, Sekretar i Përgjithshëm i SHSHB, i cili theksoi se organizimi i takimit ishte i domosdoshëm për trajtimin e problematikave në kuadër të legjislacionit kombëtar dhe atij evropian (GDPR).

Znj. Pjerina Gaxha, Drejtori i Drejtorisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, prezantoi parimet kryesore të legjislacionit kombëtar, aktet nënligjore të Komisionerit, si dhe trajtoi raste konkrete në këtë fushë. Në trajnim i ftuar i posaçëm ishte eksperti i njohur ndërkombëtar, z. Italo de Feo, nga zyra ligjore “Partner CMS” në Itali. Në prezantimin e tij u trajtuan ndryshimet dhe risitë e GDPR në raport me Direktivën 95/46, ku ndër më kryesoret janë: zgjerimi i të drejtave të qytetarëve mbi të dhënat e tyre, veçanërisht, portabiliteti i të dhënave dhe e drejta për t’u harruar; vlerësimi i impaktit të riskut dhe përgjegjshmëria e “kontrolluesit” në procesin e grumbullimit/përpunimit të të dhënave; forcimi i masave tekniko-organizative në garantimin e sigurisë; roli dhe funksionet e “oficerit të mbrojtjes së të dhënave” (DPO), etj.



Znj. Pjerina Gaxha, Drejtori i Drejtorisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, prezantoi parimet kryesore të legjislacionit kombëtar, aktet nënligjore të Komisionerit, si dhe trajtoi raste konkrete në këtë fushë. Në trajnim i ftuar i posaçëm ishte eksperti i njohur ndërkombëtar, z. Italo de Feo, nga zyra ligjore “Partner CMS” në Itali. Në prezantimin e tij u trajtuan ndryshimet dhe risitë e GDPR në raport me Direktivën 95/46, ku ndër më kryesoret janë: zgjerimi i të drejtave të qytetarëve mbi të dhënat e tyre, veçanërisht, portabiliteti i të dhënave dhe e drejta për t’u harruar; vlerësimi i impaktit të riskut dhe përgjegjshmëria e “kontrolluesit” në procesin e grumbullimit/përpunimit të të dhënave; forcimi i masave tekniko-organizative në garantimin e sigurisë; roli dhe funksionet e “oficerit të mbrojtjes së të dhënave” (DPO), etj.

“Testi i interesit publik”, transparencë dhe llogaridhënie nga Autoritetet Publike



“Testi i interesit publik” ishte tema e trajnimit të zhvilluar me stafin e Zyrës së Komisionerit nga z. Kevin Dunion, ish-Komisioneri i Informimit të Shkocisë dhe një nga ekspertët më të njohur ndërkombëtarë në këtë fushë. Trajnimi është pjesë e aktiviteteve në kuadër të “Projektit të Binjakëzimit Antikorrupsion Shqipëri-BE”. Nga një analizë e ligjit “Për të drejtën e informimit”, z. Dunion e vlerësoi në tërësi atë si mjaft bashkëkohor. Kufizimet e shprehura në neni 17 të ligjit, në mënyrë të veçantë, përbëjnë atë që konsiderohet si “Testi i interesit publik”. Çdo institucion duhet që, nëpërmjet tij, të përcaktojë faktorët për garantimin e të drejtës për informim.

Ky proces detajon edhe masat për këtë qëllim, përmbyshja e të cilave nga Autoritetet Publike do të rrisin transparencën, llogaridhënien dhe integritetin në raport me qytetarin. Gjatë trajnimit u diskutua për raste konkrete nga veprimtaria e Zyrës së Komisionerit dhe zgjidhjen e tyre. U vlerësua se eksperiencia e akumuluar nga institucioni është kontribut për ndryshimin e kulturës së administratës publike në drejtim të hapjes dhe transparencës së saj.

Bashkëpunim dhe shkëmbim eksperience me institucione të Republikës së Maltës

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, z. Besnik Dervishi, priti në një takim pune delegacionin maltez të kryesuar nga z. Deo Debattista, Sekretar i Parlamentit për Mbrojtjen e Konsumatorit, në fushën e veprimtarisë të të cilit përfshihet edhe mbrojtja e të dhënave personale.



Delegacioni përbëhej nga z. Olaf Mckay, Kryetar i Sekretariatit të Parlamentit për Mbrojtjen e Konsumatorit; z. Clayton Bartolo, deputet; znj.

Helga Pizzuto, Kryetar i Autoritetit të Konkurrencës dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe z. Godwin Mangion, Drejtor i Përgjithshëm i këtij Autoriteti.

Në takim u prezantua legjislacioni kombëtar, kompetencat dhe veprimtaria e Zyrës së Komisionerit për garantimin e dy të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Palët diskutuan për rrugët e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të eksperiencës me Autoritetin homolog maltez të Mbrojtjes së të Dhënave Personale, veçanërisht, pas hyrjes në fuqi të Rregullores së re të Përgjithshme (GDPR) në Bashkimin Evropian më 25 maj 2018.

“Në lëvizje”, Festivali shqiptar i filmit antikorrupsion



“Në lëvizje – In motion” ishte tematika e Festivalit shqiptar të filmit antikorrupsion, i cili u zhvillua në Tiranë, Shkodër dhe Korçë, në datat 7-14 dhjetor 2018.

Aktiviteti u organizua në formën e një turi ndërgjegjësues, në kuadër të “Projektit të Binjakëzimit Antikorrupsion Shqipëri-BE”, pjesë e të cilit është edhe Zyra e Komisionerit. Festivali ka për qëllim krijimin e hapësirës për trajtimin e ideve dhe iniciativave për të luftuar

këtë fenomen. Si pjesë e agjendës së tij, gjatë dy ditëve, në Tiranë dhe në Shkodër, takimet dhe diskutimet u moderuan nga znj. Ardita Shehaj, Drejtor i Drejtorisë për të Drejtën e Informimit pranë Zyrës së Komisionerit.

Veprimtaria e pushtetit vendor në raport me balancën mes dy të drejtave



Zyra e Komisionerit në bashkëpunim me Prezencën e OSBE në Shqipëri, përmbyllën, me takimin në Kukës, projektin e trajnimeve rajonale me tematikë “E drejta për informim dhe mbrojtja e të dhënave personale, njohja me detyrimet e ligjeve respektive”. Në aktivitet morën pjesë përfaqësues të institucioneve qendrore në nivel vendor, të organeve të vetëqeverisjes vendore, të sistemit të drejtësisë, policisë, medias, etj.

Z. Besnik Dervishi tha se trajtimi në balancë i dy të drejtave është një nga faktorët kryesorë të mbarëvajtjes së veprimtarisë të Autoriteteve Publike. Takimin e përshëndetën përfaqësuesi i Prezencës së OSBE në Shqipëri, z. Claudio Pala dhe Prefekti i Qarkut, z. Zenel Kuçana.

Në trajnim u prezantuan detyrimet kryesore në zbatim të ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe ligjit “Për të drejtën e informimit”. Një vëmendje e veçantë iu kushtua Rekomandimit 11/2016 të Komisionerit dhe Programit model të Transparencës për organet e vetëqeverisjes vendore, të miratuar në muajin shtator 2018. Nëpërmjet prezantimit edhe të rasteve konkrete, takimi kishte për qëllim orientimin e duhur të Autoriteteve Publike.

Mbrojtja e të dhënave personale në sistemin arsimor jopublik

Zyra e Komisionerit zhvilloi një trajnim me ftesë të shkollës së mesme jo publike “Turgut Ozal”. Në këtë takim, ku të pranishëm ishin mësues dhe staf administrativ, u trajtua ligji “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, ai “Për masat shtesë të sigurisë publike”, si dhe akte nënligjore të Komisionerit.

Znj. Pjerina Gaxha, Drejtore e Drejtorisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, prezantoi parimet kryesore të mbrojtjes së të dhënave personale, kompetencat e Autoritetit dhe raste konkrete në këtë fushë.

U trajtuan të drejtat e qytetarit: informimi, aksesimi, korrigjimi, bllokimi apo fshirja; si dhe detyrimet e “kontrolluesit” për një proces transparent, të përgjegjshëm e të sigurt të përpunimit të tyre. Vëmendje iu kushtua procedurës së “njoftimit”, “rregullores së mbrojtjes së të dhënave” dhe rolit e funksioneve të “personit të kontaktit”. Nga ana tjetër, të pranishmit u njohën me detyrimet e ligjit “Për masat shtesë të sigurisë publike” dhe aktin nënligjor të Komisionerit në zbatim të tij, i cili merr një rëndësi të veçantë për vetë natyrën e sektorit të arsimit. Në prezantim u fol për subjektet e këtij ligji, për detyrimet e tyre si “kontrollues” apo dhe për llojet e masave shtesë të sigurisë në terma teknike.



Mbyllet fushata “Privatësi dhe Siguri”

Zyra e Komisionerit përmbylli fushatën ndërgjegjësuese “Privatësi dhe Siguri”, qëllimi i së cilës ishte konsultimi i “Kwadrit të aftësisë të mësuesve të shkollave 9-vjeçare për mbrojtjen e të dhënave personale”. Gjatë fazës së dytë të saj, të zhvilluar në periudhën janar-tetor 2018, u mbajtën takime në Pogradec, Korçë, Berat, Lushnjë, Fier, Vlorë, Durrës dhe Tiranë. Pjesëmarrës në këto konsultime ishin mësues të lëndëve të qytetarisë, TIK dhe psikologë.



“Kwadri i aftësisë” përbëhet nga 9 parime për edukimin e përgjegjshëm të nxënësve për lundrimin e sigurt në mjedisin digjital dhe përdorimin e sigurt të teknologjive të reja.

Gjatë viteve të fundit, janë konstatuar raste të ekspozimit të fëmijëve dhe të rinjve ndaj fenomeneve negative të përdorimit të pakontrolluar të rrjeteve sociale. Mësuesit morën njohuri dhe informacione për mbrojtjen e privatësisë dhe të dhënave personale, për legjislacionin e fushës, për funksionin e Zyres së Komisionerit, për aspekte të procesit të përpunimit të të dhënave personale apo për të drejtat në rastet e keqpërdorimit të tyre. Autoriteti vlerëson bashkëpunimin me Drejtoritë dhe Zyrat Arsimore (DAR/ZA) për koordinimin në organizimin e takimeve të kësaj fushate.

“Kwadri i aftësisë” u miratua në 2016 në Konferencën e 38-të Ndërkombëtare të Komisionerëve të Mbrojtjes së të Dhënave dhe Privatësisë (ICDPPC). Ai është hartuar nga Grupi i Punës për Edukimin Digjital (DEWG), pjesë e të cilit është edhe Zyra e Komisionerit.

Konferenca “Të drejtat e njeriut dhe drejtësia gjinore”



Në Konferencën shkencore kombëtare “Të drejtat e njeriut dhe drejtësia gjinore”, organizuar nga Fakulteti i Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, i ftuar për të marrë pjesë ishte dhe z. Besnik Dervishi.

Aktiviteti kishte si synim njohjen me panoramën ligjore/rregullatore për garantimin e të drejtave dhe lirive

themelore të njeriut, me fokus të veçantë forcimin e barazisë gjinore dhe mbrojtjen e përkrahjen e kategorive të caktuara shoqërore. Në konferencë u prezantuan tematika dhe çështje që kanë të bëjnë me zhvillimet më të fundit në këto fusha, brenda dhe jashtë Shqipërisë (përfshi edhe risitë në mbikëqyrjen efektive të të drejtës për informim, si dhe raportin që krijohet me legjislacionin kombëtar). Nëpërmjet debatit dhe shkëmbimit të eksperiencës synohet që kontributi akademik në këtë drejtim të zgjerohet, si në aspektin teorik ashtu edhe në atë praktik.

Zyra e Komisionerit vlerëson bashkëpunimin me Fakultetin e Drejtësisë, veçanërisht, me “Klinikën e Ligjit” për rritjen e ndërgjegjësimit qytetar. Në kuadër të modernizimit të sistemit rregullator në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale në Evropë – hyrja në fuqi e Rregullores së Përgjithshme (GDPR) dhe përmirësimi i Konventës 108 të KiE, Autoriteti mirëpret dhe fton rrethin akademik për të kontribuar për standarde akoma edhe më të larta të legjislacionit shqiptar në këtë fushë.

Revista “Informim Dhe Privatësi”

Përgatitet dhe botohet nga Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Redaksia: Irma Arapi, Alketa Koja, Redi Skënderaj, Erald Mullaraj

KOMISIONERI

për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Revista nr. 6

Informim

Dhe

Privatësi

Adresa:

Rr. "Abdi Toptani", Nd. 5,
Kodi postar 1001, Tiranë

E-mail: info@idp.al

TEL: +35542237200

FAX: +35542233977

Nr. i Gjellbër: 08002050

www.idp.al